



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:206184

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05501109

KPPP.nr.1451/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit “DACI” Sh.P.K., me seli në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.K. dhe V.K. avokatë nga Peja, kundër debitorit “Icon Frame” Sh.P.K., me NUI: 811335985, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.108/22 të datës 13.09.2022, të nxjerrë nga Përmbaresi Privat Shpend Ahmetaj me seli në Pejë, jashtë seancës me datë 22.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Icon Frame” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbare P.nr.108/22 të datës 13.09.2022, të nxjerrë nga Përmbaresi Privat Shpend Ahmetaj, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, me Urdhrin Përmbare P.nr.108/22 të datës 13.09.2022, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbaremin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.02/2022 të datës 04.04.2022, me të cilin e ka lejuar përmbaremin e dhunshëm me sekuestrimin e shumës prej 5,900.00 Euro nga xhirollogaritë e debitorit të cilat gjenden në çdo Bankë Afariste të Kosovës, si dhe e ka detyruar me shpenzimet e përmbaremit.

Kundër urdhrin të Përmbauesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbaues, me arsyetimin se dokumenti në bazë të të cilit është marr vendimi përmbaues nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbaueshmëris. Më tej ka theksuar se një faturë të tillë nuk dihet se kush e ka nënshkruar dhe as kush e ka pranuar, nënshkrimet janë të palexueshme, dhe nuk përmbajnë vulat në origjinal dhe emrat e personave të autorizuar. Ka shtuar se ka paguar borxhin të cilin pretendon kreditori dhe për këtë posedon faturat e paguara në vlera prej 15,000.00 Euro, pastaj 5,000.00 Euro, pastaj 2,952.00 Euro, e për të cilat shuma në bazë të marrëveshjes verbale me kreditorin dhe vëllaun e tij I.D., të njëjtit kanë kërkuar që të kryhen këto kompensime të mallrave, ashtu që fatura për të cilën kërkon 5,900.00 Euro, është faturë e cila mbulohet me shumat për të cilat debitori ka theksuar se ka kryer transaksione për dhe në emër të z.D..... Ka kërkuar nga gjykata që nëse e sheh të arsyeshme të mbahet seancë që të vërtetohen pretendimet e palëve para gjykatës.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se asnjë nga pretendimet e debitorit të cekura në prapësim nuk qëndrojnë. Më tej ka shtuar se faturat të cilat i ka bashkangjitur se kinse i ka paguar nuk korrespondojnë me faturën për të cilën është lëshuar urdhri përmbaues, ngase shuma prej 5,900.00 Euro dhe Fatura Nr.02/2022 asnjëherë nuk është paguar. Po ashtu nuk qëndron fare pretendimi se e njëjta nuk është nënshkruar asnjëherë nga ana e debitorit, kjo vërtetohet me nënshkrimin e tij, e poashtu i njëjti e ka pranuar dhe e ka ende makinën e cila është shitur në vlerë prej 5,900.00 Euro, andaj si pretendime janë irelevante. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi dhe të lejojë urdhrin përmbaues P.nr.108/22 në tërësi si në petitum të propozimit për përmbaues.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbauesi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaues po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbaues paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet*

dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm faturën nr.02/2022 të datës 04.04.2022, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtjesore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.02/2022 e datës 04.04.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1451/23, me datë 22.03.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.